REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTËR SHTETI
PËR ÇËSHTJET VENDORE

# RAPORTI I MONITORIMIT
# VITI 2016

## STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
## KUNDËR KORRUPSIONIT
## 2015-2020

www.ceshtjetvendore.gov.al

PËRMBAJTJA


I. LISTA E SHKURTIMEVE 3

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5

III. METODOLOGJIA E MONITORIMIT 8

IV. PROGRESI I ZBATIMIT 9

V. DISBURSIMI FINANCIAR 10

VI. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE 12

VI.1 Progresi i objektivave të qasjes parandaluese 12

VI.2 Progresi i objektivave të qasjes ndëshkimore 14

VI.3 Progresi i objektivave të qasjes ndërgjegjësuese 15

VII. NEVOJA PËR RISHIKIM TË PLANIT TË VEPRIMIT 17

VIII. PARAQITJE E DETAJUAR E ZBATIMIT 18

IX. KONKLUZIONE 77

X. SFIDAT 78

XI. SHTOJCAT 79

XI.1 Matrica e monitorimit- OnLine 79

XI.2 Indeksi i masave për rishikim 80

# I. LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| AAPSK | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara |
| ADISA | *Albanian Delivery Integrated Servcies Agency* (Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara) |
| AIDA | *Albanian Investments Development Agency* (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit te Investimeve) |
| AKBN | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore |
| AKM | Agjencia Kombëtare e Mjedisit |
| AKKP | Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave |
| AKPT | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare për Shoqërine e Informacionit |
| AKU | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| AMSHC | Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile |
| AP | Avokati i Popullit |
| APP | Agjencia e Prokurimit Publik |
| AQTN | Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit |
| ASIG | Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| AKT | Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve |
| BKH | Byroja Kombëtare e Hetimit |
| BSH | Banka e Shqipërisë |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| DAETIK | *Department for European Digital Agenda and Information Technology* (Departamenti për Axhendën Evropiane Dixhitale dhe Teknologjinë e Informacionit) |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPD | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave |
| DPM | Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjisë |
| MZHETTS | Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit |
| DPPPP | Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave |
| DPSHP | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës |
| DPSHTRR | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor |
| DPS | Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit |
| DPT | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| GMIP | Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave |
| IQ | Inspektoriati Qendror |
| ILDKPKI | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave |
| IQT | Inspektorati Qendror Teknik |
| ISHPSHSH | Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore |
| KDIMDP | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| KLD | Këshilli i Lartë i Drejtësisë |
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KQZ | Komiteti Qendror i Zgjedhjeve |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |

DRAFT

| | |
|---|---|
| MBZHRAU | Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MEI | Ministria e Energjisë dhe Industrisë |
| MF | Ministria e Financave |
| MIAP | Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike |
| MK | Ministria e Kulturës |
| MM | Ministria e Mjedisit |
| MMB | Ministria e Mbrojtjes |
| MMSR | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë |
| MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MSHCV | Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore |
| MTI | Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës |
| MZHU | Ministria e Zhvillimit Urban |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PV | Plan Veprimi |
| QKR | Qendra Kombëtare e Regjistrimit |
| SHISH | Shërbimi Informativ Shtetëror |
| SHM | Shkolla e Magjistraturës |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| SNKK | Strategjia Ndersektoriale Kunder Korrupsionit 2015-2020 |
| SNRAP | Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2020 |
| ZPKR | Zyra e Prokurorisë për Krimet e Rënda |
| ZRPP | Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme |

DRAFT

# II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe përbën raportin e katërt[1] të monitorimit. Ky raport monitorimi mbulon gjithë **vitin 2016.** Raportimi dhe monitorimi janë realizuar në harkun kohor Tetor – Dhjetor 2016 dhe Shkurt – Mars 2017 nëpërmjet raportimit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion.

Ky raport monitorimi do të shërbejë për të vlerësuar ecurinë, por edhe për të identifikuar fushat për të cilat duhet të kushtohet një vëmendje e posaçme për arsye të rëndësisë që ato veshin në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

Aktivitetet janë vlerësuar në bazë të progresit të regjistruar gjatë vitit 2016.

Plani i Veprimit përmban në total **191 masa**, prej të cilave 143 masa me objektiv parandalimin, 26 masa me objektiv ndëshkimin e korrupsionit dhe 22 masa me karakter ndërgjegjësues. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për vitin 2016 rezulton se niveli i zbatimit të masave të planit të veprimit është:

**Tabela 1: Statusi i zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2016**

| Statusi i zbatimit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
|---|---|---|
| Të zbatuara plotësisht | 75 | 39% |
| Pjesërisht të zbatuara | 89 | 47% |
| Të pa-zbatuara | 26 | 14% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 1 | 0% |
| TOTAL | **191** | **100%** |

Në vijim paraqitja grafike e ecurisë së përgjithshme të zbatimit të masave të Planit të Veprimit për vitin 2016:

**Grafiku 1 -Ecuria e përgjithshme zbatimit**




Përsa i përket analizës së krahasuar të zbatueshmërisë së masave për vitin 2015 dhe vitin 2016, rezulton se:

[1] Raporti i parë i monitorimit mbulon periudhën kohore Prill 2015-Dhjetor 2015, raporti i dytë mbulon periudhën kohore Janar 2016-Qershor 2016, ndërsa raporti i tretë mbulon periudhën kohore Korrik 2016-Dhjetor 2016

- Gjatë vitit 2016 janë zbatuar 37 masa më shumë se gjatë 2015 ose niveli i zbatueshmërisë ka pësuar një rritje prej rreth 97% krahasuar me vitin paraardhës;
- Gjatë vitit 2016, ka patur një rënie me rreth 10% të masave pjesërisht të zbatuara (përkatësisht 10 masa më pak) krahasuar me vitin 2015;
- Gjatë vitit 2016 ëhstë bërë progres edhe sa i takon masave të pazbatuara, me 26 masa më pak se gjatë 2015, ose një rënie prej rreth 50%;
- Lidhur më masat e paraportuara gjatë vitit 2016, vetëm 1 masë nuk është raportuar, krahasuar me 2 masa të paraportuara në vitin 2015.

**Tabela 2: Statusi i krahasuar i zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2015- 2016**

| Statusi i zbatmit | 2015 | | 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 38 | 20% | 75 | 39% |
| Pjesërisht të zbatuara | 99 | 52% | 89 | 47% |
| Të pa-zbatuara | 52 | 27% | 26 | 14% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 2 | 1% | 1 | 0% |
| TOTAL | **191** | **100%** | **191** | **100%** |

**Grafiku 2 - Ecuria e përgjithshme zbatimit (krahasim viti 2015 me 2016)**




Në vijim të të dhënave të mësipërme, sipas një analize të integruar, rezulton se zbatueshmëria e masave të planit të veprimit, ka pësuar rritje të masave të zbatuara (në total 36 masa), numër i cili përkon edhe me uljen e nivelit të masave me status pjesërisht të zbatuar, të pazbatuar dhe të paraportuar, pra 37 masa.

**Tabela 3: Statusi i krahasuar i zbatimit të masave sipas qasjeve**

| Statusi i zbatmit | 2015 | 2016 |
|---|---|---|
| | Masat e zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara | Masat e zbatuara dhe pjesërisht të zbatuara |
| Qasja parandaluese | 100 | 120 |
| Qasja ndërshkimore | 21 | 23 |
| Qasja ndërgjegjësuese | 16 | 21 |
| **TOTAL** | **137** | **164** |

**Grafiku 3 - Ecuria e përgjithshme zbatimit sipas qasjeve (krahasim viti 2015 me 2016)**




Në kuadrin e qasjes parandaluese, gjatë vitit 2016 shënohet një avancim në zbatimin e masave me karakter parandalues, përkatësisht një rritje me 20% krahasuar me nivelin e zbatueshmërinë së masave parandaluese gjatë vitit 2015.

Për sa i përket qasjes ndërshkimore, gjatë vitit 2016 shënohet një avancim në zbatimin e masave me karakter ndërshkimor, përkatësisht një rritje prej 9.5% krahasuar me zbatueshmërinë e masave ndërshkimore gjatë vitit 2015.

Ndërsa qasja ndërgjegjësuese ka pësuar nje rritje progresive në zbatimin e masave me karakter ndërgjegjësues gjatë vitit 2016, përkatësisht një rritje prej 31% krahasuar me zbatueshmërinë e masave ndërgjegjësuese gjatë vitit 2015.

# III. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve mes pikave të kontaktit, mbi zbatimin e Masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi nga KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Me qëllim realizmin e sa më sipër, është kryer paraprakisht:

i. Grupimi i masave për çdo institucion të përfshirë në PV;
ii. Përgatitja e Matricës së Raportimit dhe udhëzimeve përkatëse;
iii. Përgatitja e Matricës së Raportimit për çdo institucion;
iv. Asistencë për Pikat e Kontaktit për kryerjen e procesit të raportimit.

Raporti i Monitorimit ka kërkuar një proces të përbërë nga 4 etapa raportimi për shumicën e institucioneve me qëllim plotësimin dhe saktësimin e informacionit të kërkuar. Zgjatja e procesit të raportimit ka qenë e nevojshme, pasi raportimi në raundet e para rezultoi i paplotë dhe/ose i paqartë në shumë nga komponentët e Matricës së Raportimit.

Në vijim, janë trajtuar të dhënat për secilën etapë dhe janë përgatitur udhëzimet me informacionet shtesë që institucionet duhet të plotësonin për kuadrin e nevojshëm të të dhënave. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht on-line[2] mes platformës së vendosur në dispozicion nga KKK, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura.

DRAFT

[2] Shiko Shtojcën 1

# IV. PROGRESI I ZBATIMIT

Tabela e mëposhtme pasqyron progresin në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet vlerave të treguesve të përgjithshëm të impaktit të Strategjisë:

| Përshkrimi i treguesit | Baseline/<br>Pikat kryesore | Synimi<br>për 2017 | Synimi<br>për 2020 | Arritja në periudhën e raportimit[3] |
|---|---|---|---|---|
| **Indeksi i perceptimit të Korrupsionit** | Sipas matjes të indeksit (0-100, ku 0 përkon me nivel të lartë korrupsioni, dhe 100 përkon me nivel të ulët korrupsioni)<br>Shqipëria ka indeksin **33** | **37.5**<br>(Rritje prej 1.5-2.5 pikësh çdo vit) | **40.5**<br>(Rritje prej 1.5-2.5 pikësh çdo vit) | **39**<br>Në 25 janar 2017, vlera e indeksit të perceptimit të korrupsionit per 2016 ka pësuar një rritje prej 3 pikësh nga viti 2015, duke e pozicionuar Shqipërinë në vendin e 83 prej 168 vendesh të listës së *Transparency International* me 39 pikë. |
| **Kontrolli i Korrupsionit, Banka Botërore** | Indikator i përbërë i cili mat gjendjen e korrupsionit dhe evidenton përqindjen e vendeve që janë nën atë performancë<br>Shqipëria renditet më mirë se **25.84%** e vendeve të tjera që vlerësohen. | Shqipëria performon më mirë se **34%** e vendeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin | Shqipëria performon më mirë se **40%** e vendeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin | **Nuk ka pasur raport të ri për këtë tregues.**<br>Ky indikator në 2015 shënoi një përmirësim, duke kapur nivelin **40.4 %.** |
| **Studimi mbi performancën e Mjedisit të Sipërmarrjes dhe të Investimeve, Banka Botërore** | Si në studimin e 2005, ashtu edhe të 2008, korrupsioni ishte pengesë e rendësishme për biznesin (renditur i **dyti** në rendësi) | Korrupsioni nuk përbën një nga 3 pengesat më të rendësishme për biznesin | Korrupsioni nuk përbën një nga 4 pengesat më të rendësishme për biznesin | **Nuk ka pasur raport të ri për këtë tregues.**<br>Në studimin e 2013-2014, rezulton se ka pasur disa përmirësime krahasuar me rezultatet e studimeve të mëparshme, gjithsesi korrupsioni përbën një nga 3 pengesat më të rendësishme për biznesin. |
| **Raport i Nations in Transit** | Vlerësimi për situatën e korrupsionit në Shqipëri është **5.25** (ku 1=shumë mirë, 7= shumë keq)<br>Mesatarja e vlerësimeve për vendet e BE është **3.43** ndërsa për vendet e Ballkanit **4.79** | Vlerësimi për Shqipërinë është **4.5** | Vlerësimi për Shqipërinë është **4.2** | **Nuk ka pasur ndryshim për këtë tregues.**<br>Vlerësimi për 2016 mbetet i pandryshuar në krahasim me një vit më parë: **5.25** |
| **Rekomandimet e GRECO për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit në rradhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe parlamentarëve** | 10 rekomandime janë dhënë për Shqipërinë në raundin e 4-t të vlerësimeve, në 2014 | Të gjitha rekomandimet e raundit të 4-t janë zbatuar plotësisht | Të gjitha rekomandimet e raundit të 5-t janë zbatuar plotësisht | **Nuk ka pasur ndryshim për këtë tregues**<br>Raporti i GRECO mbi raundin e 4 të vlerësimit është publikuar në dt. 15.04.2016. 9 nga 10 rekomandime të GRECO janë vlerësuar "pjesërisht të zbatuara", ndërsa rekomandimi i 10-të u konsiderua "i zbatuar në mënyrë të kënaqshme".<br>Aktualisht[4] është në proces vlerësimi i dytë në kuadër të të njëjtit raund Nr. 4. |

[3] Janë përditësuar ato tregues ku ka patur ndryshime në krahasim me raportin e mëparshëm të monitorimit të vitit 2015.
[4] Janar 2017.

# V. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e Planit të Veprimit 2015-2017 është 1,7 Mld Lek, ose 12,3 Mln Euro. Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtar të zhvillimit. Buxheti i Shtetit është parashikuar të financoj zbatimin e aktiviteteve të planit të veprimit masën 49% të financimit të nevojshëm. Ndërsa pjesa tjetër është parashikuar të financohet nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit si Bashkimi Europian, Banka Botërore, UNDP, OSBE, USAID, etj. Në momentin e hartimit të planit të veprimit **hendeku financiar është vlerësuar të jetë në masën 23% të totalit**. Meqënëse hendeku financiar apo edhe kosto e përgjithshme e PV 2015-2017 nuk është rishikuar që prej aprovimit të Strategjisë, statistikat financiare të raportuara në vijim i referohen shifrave në momentin e miratimit të planit të veprimit:

**Grafiku 4 - Disbursimi financiar viti 2016**




Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, institucioneve përgjegjëse u është këruar të raportojnë mbi **masën e disbursimit financiar në bazë aktiviteti të kryera gjatë vitit 2016.** Në total, raportohen **disbursime financiare në vlerën 414,437,184 lekë ose 24.4% e kostos së PV**, ku 3.4% është mbuluar sipas raportimit, nga ndihma e partnerëve ndërkombëtar të zhvillimit dhe 21% nga buxheti i shtetit.

Nga shuma totale e raportuar e disbursimit, 357,041,570 lekë janë disbursuar nga buxheti i shtetit ose rreth 86% dhe 57,395,614 lekë nga partnerët ndërkombëtar të zhvillimit, ose rreth 14% të buxhetit total të disbursuar gjatë këtij viti.

**Grafiku 5 - Disbursimi financiar (krahasimi i vitit 2015 me vitin 2016)**




**Grafiku 6 - Krahasimi i disbursimit financiar ndër vite**







Grafiku më sipër paraqet një kuadër të situatës financiare të Planit të Veprimit të SNKK 2015-2020, krahasuar me vitin paraardhës (2015). Kështu rezulton se gjatë vitit 2016 shënohet një rritje e disbursimit financiar nga Buxheti i Shtetit në masën +135%, krahasuar me vitin 2015. Ndërkohë që fondet e disbursuara nga donatorët e huaj kanë pësuar një rënie gjatë vitit 2016 me rreth 60%, krahasuar me vitin 2015.

Në total, progresivisht me vitin 2015 është disbursuar 42% e kostos së Strategjisë.

**Megjithatë vërehet se, përtej kostos së llogaritur në momentin e miratimit të Strategjisë në vitin 2015, institucionet kanë disbursuar fonde të cilat e kanë tejkaluar koston e kësaj Strategjie dhe për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2016 ato raportojnë shifrën rreth 1,1 Mld lekë ose rreth 64% më shumë se kostoja fillestare e kësaj strategjie.**

# VI. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull do të përshkruajë progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së objektivave të secilës qasje të Strategjisë dhe do të pasqyrojë grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për vitin 2016.

Ecuria e progresit në periudhën e monitoruar është klasifikuar në 3 kategori:

1. **I zbatuar**: Institucionet kanë raportuar "I zbatuar" zbatimin e Masës për periudhën e raportit me të gjithë treguesit e zbatimit. Për masat me tregues zbatimi periodik, institucionet kanë paraqitur edhe hapat në vijim.
2. **Pjesërisht i zbatuar**: Institucionet kanë raportuar me këtë status ato Masa për të cilat në periudhën e raportit ka pasur zbatim të pjesshëm. Institucionet kanë raportuar edhe mbi hapat ne vijim për zbatimin e plotë të Masës.
3. **I pa-zbatuar**: Të pa-zbatuara janë raportuar ato Masa të cilat nuk kanë regjistruar aktivitete për periudhën në fjalë. Gjatë procesit të raportimit, është synuar mbledhja e informacionit edhe në lidhje me hapat që institucionet e përfshira planifikojnë të ndërmarrin në periudhën pasuese.

Në një kategori tjetër përfshihen masat për të cilat institucionet përgjegjëse nuk kanë raportuar.

## VI.1 Progresi i objektivave të qasjes parandaluese

Qasja parandaluese shënon numrin më të madh të aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikohet të zbatojnë gjatë gjithë periudhës 3-vjeçare të Planit të Veprimit. Gjatë periudhës së raportimit (viti 2016), institucionet përgjegjëse kanë raportuar: 56 masa të zbatuara, 22 ende të pa-zbatuara dhe 64 pjesërisht të zbatuara. Institucionet nuk kanë raportuar progres të zbatimit vetëm për 1 masë[7].

**Tabela 4: Progresi i krahasuar i zbatimit- Qasja Parandaluese**

| QASJA PARANDALUESE Statusi i zbatimit | 2015 | | 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 28 | 20% | 56 | 39% |
| Pjesërisht të zbatuara | 72 | 50% | 64 | 45% |
| Të pa-zbatuara | 43 | 30% | 22 | 15% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 0 | 0% | 1 | 1% |
| TOTAL | **143** | **100%** | **143** | **100%** |

[7] Masa A.1.18

DRAFT

**Grafiku 7 – Qasja parandaluese: Ecuria e zbatimit të masave, viti 2016**




Grafiku në vijim ilustron ecurinë e zbatimit duke krahasuar dy raportet e monitorimit, vitin 2015 me vitin 2016. Vihet re një rritje e numrit të masave të zbatuara, një trend zbritës i masave të pazbatuara dhe atyre pjesërisht të zbatuara.

**Grafiku 8 - Qasja parandaluese: Ecuria e zbatimit të masave, e krahasuar 2015-2016**



## VI.2 Progresi i objektivave të qasjes ndëshkimore

Në kuadër të qasjes ndëshkimore, gjatë periudhës së raportimit, institucionet përgjegjëse kanë raportuar 6 Masa të zbatuara, 3 ende të pa-zbatuara dhe 17 pjesërisht të zbatuara. Në vijim, tabela përmbledhëse me statusin përkatë të zbatimit:

**Tabela 5: Statusi i krahasuar i zbatimit: Qasja Ndëshkimore**

| QASJA NDËRSHKIMORE Statusi i zbatimit | 2015 | | 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 3 | 12% | 6 | 23% |
| Pjesërisht të zbatuara | 18 | 69% | 17 | 65% |
| Të pa-zbatuara | 4 | 15% | 3 | 12% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 1 | 4% | 0 | 0% |
| TOTAL | **26** | **100%** | **26** | **100%** |

**Grafiku 9 - Qasja ndëshkimore: Ecuria e zbatimit të masave, viti 2016**




Grafiku në vijim ilustron ecurinë e zbatimit duke krahasuar dy raportet e monitorimit, vitin 2015 me vitin 2016. Vërehet një rritje e numrit të masave të zbatuara, një trend rënës për masat pjesërisht të zbatuara dhe ato të pazbatuara nga institucionet përgjegjëse:

**Grafiku 10 - Qasja ndëshkimore: Ecuria e zbatimit të masave, e krahasuar 2015-2016**




## VI.3 Progresi i objektivave të qasjes ndërgjegjësuese

Në kuadër të qasjes ndërgjegjësuese, gjatë periudhës së raportit, institucionet përgjegjëse kanë raportuar 13 Masa të zbatuara, 1 ende të pa-zbatuara dhe 8 pjesërisht të zbatuara.

**Tabela 6: Statusi i krahasuar i zbatimit: Qasja Ndërgjegjësuese**

| QASJA NDËRGJEGJËSUESE Statusi i zbatimit | 2015 | | 2016 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 7 | 32% | 13 | 59% |
| Pjesërisht të zbatuara | 9 | 40% | 8 | 36% |
| Të pa-zbatuara | 5 | 23% | 1 | 5% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 1 | 5% | 0 | 0% |
| TOTAL | **22** | **100%** | **26** | **100%** |

**Grafiku 11 - Qasja Ndërgjegjësuese:: Ecuria e zbatimit të masave, viti 2016**




Grafiku në vijim ilustron ecurinë e zbatimit duke krahasuar dy raportet e monitorimit, vitin 2015 me vitin 2016. Vihet re një rritje e numrit të masave të zbatuara krahasuar me vitin 2015 nga institucionet përgjegjëse, një rënie në numrin e masave pjesërisht të zbatuara dhe atyre të pazbatuara.

**Grafiku 12 - Qasja Ndërgjegjësuese: Ecuria e zbatimit të masave, e krahasuar 2015-2016**



# VII. NEVOJA PËR RISHIKIM TË PLANIT TË VEPRIMIT

Institucionet kanë raportuar nevojën për **rishikimin e 30 Masave** nga 191 që përmban Plani i Veprimit, ose përafërsisht 15.7% e tyre. Kjo nevojë rishikimi lidhet kryesisht me faktorë si:

- modifikime në përmbajtjen e Masës dhe/apo treguesve të saj të zbatimit, apo ndryshimeve ligjore në proces dhe/ose të hyra në fuqi;
- ndryshimin e kostos financiare;
- ndryshimin e përgjegjësisë institucionale për zbatim dhe/apo institucioneve bashkëpunuese.

**Grafiku 13: Rishikimi i masave sipas qasjeve**




Nga këto, 23 masa përfshihen në qasjen parandaluese, 2 masa të karakterit ndërshkimor dhe 5 masat e fundit i përkasin qasjes ndërgjegjësues. Në Shtojcën 2, reflektohet një ekstrakt i indeksit të masave të cilat institucionet raportuese propozojnë për rishikim, në mënyrë progresive për të gjithë kohëzgjatjen e monitorimit[10].

---

[10] Shih Shtojcën 2

# VIII. PARAQITJE E DETAJUAR E ZBATIMIT

Ky kapitull detajon masë për masë raportimin e çdo institucioni përgjegjës për periudhën e këtij raporti, sikurse dhe nënvizon rekomandimet për rishikim për çdo aktivitet. Kapitulli ofron gjithashtu informacion lidhur me statusin kumulativ, i cili merr parasysh raportimet e mëparshme dhe përcakton statusin përfundimtar[11] të zbatimit të Masave të Planit të Veprimit. Për lehtësi të monitorimit të ecurisë së përgjithshme, në kolonën "Statusi kumulativ i zbatimit" do të paraqesim me ngjyrë:

- **Jeshile:** masat me progres të plotë
- **Kuqe:** masat e pazbatuara ose me zero progres
- **Portokalli:** masat në proces zbatimi

| Nr | Aktiviteti | Institucioni Përgjegjës | Afati kohor | Progresi | Problemet dhe hapat e ardhshem | Buxheti i përdorur |
|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.1 | Finalizimi i regjistrit themeltar të vendimmarrjes së kthimit dhe kompensimit | Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (AKKP) | Maj 2015 | I zbatuar<br><br>Masë e zbatuar që në vitin 2015 | | |
| A.1.2 | Rekrutimi i punonjësve mësimore sipas profilit përkatës dhe në bazë të meritës e preferencës | Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) | 2015 - 2017 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Ka perfunduar edhe faza e dytë e testimit të kandidatëve për ushtrimin e profesinit të mesuesve për vitin shkollor 2016-2017. Udhezimi Nr. 38 i nxjerre perpara për këtë proces, krijoi kuadrin e plotë të implementimit të këtij procesi. Të dhënat janë publikuar në faqen zyrtare të MAS dhe të DAR/ZA. | Procesi do të vijojë me publikimin e rankimit të kandidatëve të testuar. Afati kohor i përfundimit të këtij procesi pritet të jetë viti 2017. | |
| A.1.3 | Vlerësimi vjetor i mësuesve në bazë perfomance | Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) | 2015 - 2017 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Eshte bere testimi i mesuesve ne nivel kombetar. Vleresimi synoi pikerisht identifikimin e treguesve te performances. Raporti eshte i publikuar ne faqen zyrtare te MAS si dhe ne faqen zyrtare te IZHA.<br>Është kryer unifikimi i treguesve të performancës, tregues të cilët janë paraqitur në Kartën e Performancës. Kjo kartë do të shërbejë si një instrument vetvlerësimi nga ana e shkollave dhe nga ISHA si instuticion i monitorimit të aplikimit të këtyre treguesve të | Ndërkohë pritet Inspektimi nga ISHA në përputhje me Kartën e Performancës. Afati kohor i përfundimit të këtij procesi pritet të jetë viti 2017. | |

[11] Në Dhjetor 2016

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | unifikuar. | | |
| A.1.4 | Vlerësim teknik i sistemit të integritetit akademik në arsimin e lartë, dhe vlerësimi i aplikimit të një sistemi elektronik për kontrollin e plagjiaturës | Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) | 2016-2017 | I pazbatuar<br><br>Nuk ka filluar ende zbatimi për këtë masë. Synohet hartimi i projekt-vendimit për ngritjen e sistemit antiplagjiaturë të doktoratave. | Afati kohor i përfundimit të këtij procesi pritet të jetë viti 2018.<br><br>Kjo nënkupton që **kjo masë ka nevojë për rishikim** pasi nuk mund të realizohet brenda këtij plani veprimit i cili ka afat deri në Dhjetor 2017. | |
| A.1.5 | Publikimi në faqen e DPM-së të emrave të subjekteve të autorizuar për kryerjen e shërbimeve metrologjike | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) | Dhjetor 2015/2016/ 2017 | I zbatuar<br><br>Në faqen zyrtare të DPM-së janë publikuar emrat e 13 subjekteve të autorizuar, adresa e tyre, numri i vendimit dhe data e autorizimit përkatës për secilin prej subjekteve, si dhe objekti i veprimtarisë (Lloji i autorizimit). Janë publikuar përkatësisht, emrat e 4 subjekteve për verifikim të çisternave rrugore; 4 subjekte për verifikim të matësave të energjise elektrike; 4 subjekte për verifikim të matësave të ujit të pijshëm; 1 subjekt për verifikim të çisternave automobilistike. | Zbatimi i kësaj mase do të jetë në vazhdimësi për gjithë vitin 2017. | Buxheti i disbursuar është 108 000 lekë dhe këto fonde janë disbursim i Buxhetit të Shtetit për vitin 2016. |
| A.1.6 | Hartimi dhe publikimi i manualeve standarde për procedurat e koncesioneve | Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATK) | Korrik 2015 | I zbatuar<br><br>Manuali Udhëzues mbi koncesionet/ppp është hartuar, në dy versione Shqip dhe Anglisht, dhe është publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të koncesioneve sipas link:<br>http://www.atrako.gov.al/wp-content/uploads/2016/10/Manual-per-perdoreusit.pdf<br>Ky manual është botuar dhe shpërndarë në trajnimet e organizuara për përdorimin e tij me aktorët kryesorë të përfshirë në këto procedura. Konkretisht:<br>1. Trajnim me MZHETTS dhe institucionet e varesise me date 4 tetor;<br>2. Trajnim me përfaqësues të ministrive të linjës më datë 18 tetor;<br>Më datë 21 nëntor 2016 është realizuar një ëorkshop me temë *'Prezantimi i manualit udhëzues mbi procedurat për dhënien me koncesion/ppp*'. Ky ëorkshop është organizuar me përfaqësues të 30 njësive të qeverisjes vendore. Manuali ka perfunduar. Duke qenë se këto ëorkshope organizohen vazhdimisht kjo masë konsiderohet e zbatuar për periudhën e raportimit. | Për vitin 2017 është planifikuar organizimi i disa ëorkshop-eve me grupe me të vogla në njësitë kryesore të qeverisjes vendore të cilët kanë parashtruar nevojën për të marrë më shumë informacion mbi procedurat për dhënien me koncesion. Këto ëorkshope do të organizohen në Bashkinë Elbasan, Korçë, Berat, Durrës, Gjirokastër, Kukës dhe Shkodër. Afat i ri kohor I kryerjes së këtyre ëorkshopeve është periudha Mars-Prill 2017, pra fundi i Tremujorit të I dhe fillimi i Tremujorit të II. | Buxheti i disbursuar: 322.680 leke (PBA) |
| A.1.7 | Pajisja e punonjësve të policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera vëzhgimi gjatë kryerjes së | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Në zbatim të urdhrit nr.1/1028, datë 30.06.2016 Për zhvillimin e trajnimit me temë "Njohja me sistemin e kamerave të trupit", nga data 01 – 22 Korrik 2016, në ambientet e Akademisë së Sigurisë është zhvilluar trajnimi për kamerat e uniformës më këto modalitete;<br>- Numri i punonjësve të trajnuar 1100<br>- Kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve; punonjës policie të patrullës së | Trajnimi do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme të raportimit. | Nuk ka një buxhet të disbursuar për periudhën e raportimit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | detyrave | | | përgjithshme, seksionit të forcës së posaçme “shqiponja” dhe patrulla të policisë rrugore të DVP Tiranë.<br>- Numri i filmimeve nga momenti i fillimit të projektit pilot te kamerave të trupit deri në fund të vitit 2016 shkon ne shifrën e 90 000 regjistrimeve të ndryshme | | |
| A.1.8 | Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve publike | Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS) | Çdo tre muaj 2015-2017 | I zbatuar<br><br>Ne shkurt 2016 funksioni i programimit dhe monitorimit te investimeve eshte transferuar prane Ministrise se Financave e cila eshte pergjegjese per publikimin e raporteve per periudhen ne vijim.<br>Do te vazhdoje publikimi por tani eshte pergjegjesi e M.F. | Sugjerohet **rishikimi i institucionit përgjegjës** për raportimin e kësaj mase gjatë procesit të rishikimit të Planit të Veprimit 2015-2017 të SNKK 2015-2020. | |
| A.1.9 | Hartimi i Programeve të Transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit | Të gjitha ministritë | 1 Maj 2015 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>15 institucione kane raportuar gjate 6-mujori te parë 2016 dhe 28 institucione kane raportuar gjate 6-mujori te dyte 2016 mbi zbatueshmerine e kesaj mase | | |
| A.1.10 | Krijimi i strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit | KDIMDP | 2015-2016 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Struktura e drejtorisë për të drejtën e informimit nuk ka ndryshuar. Gjatë kësaj periudhe stafi i kësaj drejtorie ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ASPA por edhe në konferenca ndërkombëtare, me synim rritjen e kapaciteteve. Gjatë kësaj periudhe janë caktuar dhe 30 Koordinatore të rinj për të drejtën e informimit. Zyra e Komisionerit ka vijuar me trajnimet e koordinatorëve. | Hapa ne vijim: Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit, monitorimi i Autoriteteve publike për caktimin e koordinatorit. | Fondi i shpenzuar ka qenë 2.229.000 ALL, i cili është vetëm fondi i pagave për drejtorinë e të drejtës për infomim, pra burimi i financimit të masës është Buxheti i Shtetit |
| A.1.11 | Instalimi i sistemit audio në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë | MD | Dhjetor 2015 | I zbatuar<br><br>Deri ne muajin qershor 2016, sistemi audio funksionon ne 36 gjykata te shkalles se pare dhe te apelit. Niveli i perdorimit te ketij sistemi ne vlera te peraferta ishte ne masen 62%. Theksojme se kishte gjykata qe nivelin e perdorimit e kishin ne masen 100%, por nderkohe qe kishte edhe gjykata ku eshte instaluar sistemi audio, te cilat, kryesisht per shkak te infrastruktures se kufizuar qe lidhet me numrin e vogel te sallave te gjykimit ne raport me numrin e gjyqtareve dhe te ceshtjeve gjyqesore per gjykim, e kishin nivelin e perdorimit nen masen 50%.<br>USAID me Projektin "Just for all" vijues i Projektit "Just", me mbeshtetjen e Ministrise se Drejtesise do te mundesoje ne muajt ne vijim (pergjate periudhes korrik - shtator) venien ne funksionim te sistemit audio edhe ne Gjykaten Administrative te Shkalles se Pare Gjirokaster (gjykata e fundit). | Në vijimesi do të monitorohet niveli i përdorimit nga gjykatat i sistemit audio dhe ky proces pritet të përfundojë në muajin Shkurt 2017. Megjithatë masa konsiderohet e zbatuar pasi procesi i monitorimit nuk është pjesë e zbatimit të kësaj mase. | Buxheti i disbursuar për realizimin e kësaj mase gjatë periudhës së raportimit përbëhet vetëm nga kostot administrative të cilat janë të mbuluara nga Buxheti i Shtetit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në muajin tetor 2016, filloi funksionimi i sistemit dixhital me regjistrim audio te sencave gjyqesore edhe ne Gjykaten Administrative te Shkalles se Pare Gjirokaster. Me kete realizim, u kompletua panorama shtrirjes se sistemit audio ne te gjitha gjykatat e shkalles se pare dhe te apelit. tashme sistemi funksionon ne 37 gjykata (29 gjykata te shkalles se pare dhe 8 gjykata te apelit), në Gjykatën e Lartë dhe në një sallë gjykimi imitues në Shkollën e Magjistraturës. Niveli i perdorimit te tij ne rang te pergjithshem te gjykatave te faktit ne vlera mesatare per vitin 2016 eshte 79.3%. | | |
| A.1.12 | Publikimi i dëgjesave dhe vendimeve në përfundim të procedurave paraprake për vlerësimin e ndikimit në mjedis | Ministria e Mjedisit (MM) | Çdo tre muaj 2015-2017 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Gjate periudhes Janar - Qershor MM ka organizuar 8 Degjesa Publike per akte ligjore dhe nenligjore.<br>MM ka zhvilluar 18 Degjesa Publike per strategji, dhe akte ligjore. Informacioni i plote, ne lidhje me pjesemarresit, minutat e takimit dhe datat e sakta te organizimit te DP gjenden ne faqen zyrtare te Ministrise se Mjedisit, ne linkun (http://www.mjedisi.gov.al/al/programi/sherbime-dhe-transparence/degjesa-me-publikun).<br>Nga ana tjeter, ne lidhje me zhvillimin e DP nga ana e AKM dhe strukturave te saj ne rrethe, AKM informon se ato marrin rreth 30 aplikime ne muaj per leje apo VNM (http://www.akm.gov.al/publiku.html), degjesat e te cilave kryhen nga Agjencite Rajonale te Mjedisit. | Deri ne fund te Janarit 2017, sic edhe e parashikon Ligji per te Drejten e Informimit dhe Ligji per Njoftimin dhe Konsultimin Publik, MM do te hartoje raportin vjetor per zbatimin e ligjeve dhe publikoje listen e plote te detyrimeve nga ligjet e siperpermendura. AKM do te vijoje punen per pergatitjen e Raportit te GJendjes Mjedisore te vitit 2016, i cili duhet te percillet ne KM nga fundi i Korrikut 2017. Gjithashtu ne lidhje me organizimin e Degjesave Publike nga ana e ARM rajonale per procedurat e VNM dhe lejeve mjedisore, MM do te organizoje brenda Marsit 2017, nje trajnim me te gjithe drejtuesit e agjencive Rajonale te Mjedisit me tematike: Organizimi i Degjesave Publike, si detyrim i Konventes se Aarhusit dhe legjislacionit kombetar.<br>Afati i rikohor i zbatimit të kësaj mase pritet të jetë TM 2 i vitit 2017. Nuk ka kosto për realizimin e saj. | |
| A.1.13 | Bërja publike e raporteve të monitorimit për ndikimin në mjedis të projekteve dhe e numrit të ankesave nga publiku | Ministria e Mjedisit (MM) | Çdo janar 2015-2017 | I zbatuar<br><br>Ministria e Mjedisit: ne portalin https://ssl.kryeministria.al/ankesat/issues/my/closed jane depozituar dhe perpunuar 21 ankesa nga publiku drejtuar MM ose institucioneve te vartesise gjate periudhes se raportimit. Ndersa kerkesat e tjera per informacion mjedisor gjate kesaj periudhe jane ne total 31 dhe jane te pasqyruara ne raportet permbledhese te Regjistrit te Kerkesave per informacion mjedisor Janar-Mars 2016 dhe Prill-Qershor 2016, qe gjenden ne faqen zyrtare, ne linkun http://www.mjedisi.gov.al/al/programi/sherbime-dhe-transparence/programi-i- | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | transparences . | | |
| A.1.14 | Pasqyrimi i tarifave të çdo shërbimi në QSUT | Ministria e Shëndetësisë (MSH) | Korrik 2015 | I zbatuar<br><br>Informacioni i publikuar on-line. Masë e përfunduar gjatë 6-mujorit të parë 2016. Transparence sa i perket tarifave te sherbimeve QSUT. | Ndër hapat e ardhshëm përmendet mbajtja e perditesuar e tarifave te percaktuara, si ne faqen ëeb ashtu dhe ato te vendosura ne recepsione QSUT. | Buxheti i disbursuar për realizimin e kësaj mase përbëhet vetëm nga kostot administrative të cilat janë të mbuluara nga Buxheti i Shtetit. |
| A.1.15 | Mirëmbajtja e Regjistrit të Zhvillimit të Territorit në lidhje me sigurinë e hedhjes së të dhënave, nga përdoruesit e ndryshëm dhe përditësimi i saj | AKPT | 2015 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Mirembajtja e sistemit te ri multifunksional ka nevoje per Update, modifikime dhe zhvillime te herepashershme ne lidhje me aplikimet dhe per ti ardhur ne ndihme perdoruesve te tij.<br><br>Autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit e-leje është AZHT. | **Masa ka nevoje per rishikim** pas ngritjes se AZHT. | |
| A.1.16 | Përmirësimi i metodologjisë për përcaktimin e kategorive në fushën e licencimit profesional të pasurive të paluajtshme (studim, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim) | MZHETTS | 2015-2017 | I zbatuar<br><br>Janë përmbledhur dhe përpunuar gjithë mendimet dhe sugjerimet e ardhura nga grupet e interesit. Janë riformatuar kategoritë e licencimit në fushën e studim-projektimit dhe mbikëqyrje -kolaudimit të punimeve të ndërtimit, është hartuar drafti i rregullores dhe po pritet të merren mendimet nga ministritë e linjës. Ndërkohë, rregullorja e re që rregullon licencimin në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme është miratuar nga KM dhe pritet të hyjë në fuqi me botimin e VKM në fletoren zyrtare. Ky vendim ndryshon edhe mënyrën e aplikimit për licencim, duke futur aplikimin on line, nëpërmjet sistemit informatik të integruar, që është realizuar si projekt pranë MZHU.<br>Eshte miratuar rregullorja e re e licencimit ne fushen e studimit e projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim me VKM nr. 943, date 28.12.2016. Ne kete rregullore jane riformatuar kategorite e licencimit ne kete fushe, pasi jane konsultuar me gjithe grupet e interesit dhe institucionet universitare. Gjithashtu, me rregulloren e re, aplikimi per licencimin ne kete fushe, brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e VKM, mund te kryhet nepermjet sistemit online, ne portalin e sherbimeve qeveritare ealbania , ose me poste, ndersa pas 6 muajve do te kryhet vetem online. | | |
| A.1.17 | Aksesi në portalin online *e-Inspektimi* | Inspektoriati Qendror (IQ) | Maj 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Nuk ka informacion mbi zbatueshmerinë e mëtejshme të kesaj mase pasi IQ nuk ka | **Disbursuar 9,450,000.00 Lekë** (Burimi i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Portali eshte i aksesueshem nga ISHPSHSH, ISHSH, ISHMP. Ne proces implementimi eshte dokumentacioni standard i ISHA, i cili duhej të perfundonte deri ne fund te Janar-it 2016. Gjithashtu, ne proces implementimi eshte edhe Inspektorati i Ujrave.<br>Procesi i implementimit te ketij dokumentacioni duhej të perfundonte deri ne fund te Shkurt 2016. | raportuar për periudhën 6-mujori II 2016 | finacimit: PBA). |
| A.1.18 | Publikimi i kritereve dhe kushteve të percaktura në VKM "Për testimin dhe rekrutimin e Inspektorëve" | Inspektoriati Qendror (IQ) | 2015 | Pa raportim | IQ nuk ka raportuar gjatë vitit 2016 lidhur me zbtueshmërinë e kësaj mase | |
| A.1.19 | Transparencë për alokimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA | AIDA | Çdo vit | I zbatuar<br><br>Për 6mujorin e parë 2016:<br>**Fondi i Konkurrueshmërisë:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar, 37 aplikime, 19 projekte të aprovuara; Nr. i aplikimeve dhe i fituesve i publikuar në faqe. Fondi total vjetor për vitin 2016 është 28,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 6.587.570 ALL.<br>**Fondi i Inovacionit:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar, 2 aplikime, keto dy projekte jane ne proces shqyrtimi. Fondi total vjetor për vitin 2016 është 15,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 0 ALL.<br>**Fondi i Ekonomisë Kreative:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar: 10 aplikime; 10 projekte të aprovuara. Nr. i aplikimeve dhe i fituesve i publikuar në faqe. Fondi total vjetor për 2016 është 10,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 2.986.300 ALL;<br>**Fondi i Grave Sipërmarrëse:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar, 0 aplikime; 0 projekte të aprovuara. Fondi total vjetor për 2016 është 10,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 0 ALL.<br>**Fondi Start-up:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar, 14 aplikime, 12 projekte të aprovuara. Nr. i aplikimeve dhe i fituesve i publikuar në faqe. Fondi total vjetor për 2016 është 10,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 1.616.200 ALL.<br>**Fondi Voucher Scheme:** Kushtet, afatet, kriteret, për periudhën janar - qershor 2016 publikuar, 0 aplikime, 0 projekte të aprovuara. Fondi total vjetor për vitin 2016 është 4,000,000 ALL, ndërsa fondi i miratuar 0 ALL.<br><br>Për vitin 2016:<br>Fondi i Konkurrueshmerise u realizua ne masen 97,5%, Fondi i Ekonomise Kreative u realizua ne masen 99.3%, Fondi i Start-up u realizua ne masen 97,7%, dhe Fondi i Inovacionit u realizua ne masen 40%.<br>Per realizmin e Fondeve te menaxhuara nga AIDA, per periudhen Korrik -Dhjetor 2016, nga stafi i AIDAs u be promovimi i fondeve nga muaji Korrik deri ne Nentor 2016 ne qytetet kryesore te Shqiperise si:Durres, Berat,Shkoder,Korce, Vlore, etj. U realizuan | | Buxheti i disbursuar per periudhen Janar – Qershor 2016 është 11,190,070 ALL Buxheti i disbursuar (PBA), për periudhën Korrik-Dhjetor 2016, per te 4 fondet ne total eshte 42,650,526 lekë dhe financimi i tij është nga Buxheti i Shtetit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | takime me tavolina te rrumbullakta me SME e ketyre qytetve ne bashkepunim me dhomat e tregtise dhe shoqatat e bizneseve. | | |
| A.1.20 | Transparencë në fondet që alokohen për projektet kulturore | Ministria e Kulturës (MK) | Çdo vit | I zbatuar<br><br>Ne lidhje me raportimin ne kete periudhe sqarojme se shpallja e fituesve te thirrjes per projekt-propozime ne art kulture dhe trashegimi kulturore behet ne 3 mujorin e pare te cdo viti. Nderkohe eshte shpallur lista e fituesve dhe projektve per vitin 2017 http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme/thirrja-per-projekt-propozime-per-vitin-2017-projektet-e-perzgjedhura-per-mbeshtetje-ne-art-kulture-dhe-trashegimi-kulturore&page=1 .<br>Ndërkohë realizohet publikimi online i cdo informacioni lidhur me kushtet dhe kritere per aplikimet per projekte ne MK. | Gjithashu do te behet transparenca e hapave te metejshem te zbatimit te ketyre projekteve nga fituesit. | Fondi i dhene per projektet me thirrje per vitin 2017 eshte 40.000 000 leke nga buxheti i MK. |
| A.1.21 | Publikimi online i komponentëve të Shërbimit Këshillimor Publik (Ekstensioni Bujqësor) | Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar<br><br>Me mbështetjen e projektit "SARED" për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ekonomik Bujqësor të Zonave Rurale të Pafavorizuara në Shqipëri po punohet për ringritjen e platformës, duke bërë edhe një rifreskim të strukturë së saj. | Hapat e mëtejshëm si dhe afati kohor për zbatimin përfundimtar të kësaj mase janë në varësi të projektit "SARED". | |
| A.1.22 | Krijimi ne QSUT i qendrës së informimit të publikut | Ministria e Shëndetësisë (MSH) | 2015 | I zbatuar<br><br>Masë e realizuar që në raportimin e vitit 2015.<br>Mbi 9000 prenontime konsultash ne linjen 08002828 si dhe prezenciale/mbi 3500 perfitues sherbimesh te ndryshme. | | 10.998 /pagesa e linjes se telefonit, e cila është mbeshtetur nga Buxheti i Shtetit, ndërkohë që masa është financuar me donacion. |
